



**3. Veprimtaria e agentit do të ushtrohet në:**

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës

B. Klasat e sigurimit të Jetës

**4. Agjentët e punësuar në shoqëri do të jenë:**

Emër..... Mbiemër..... Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

Emër..... Mbiemër..... Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

Emër..... Mbiemër..... Miratuar me Vendim Bordi , nr.....dt.....

**Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.**

**Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionin bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi .**

Personi Kërkues:

\_\_\_\_\_  
( Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Data \_\_\_\_\_

Shënim:

- 1. Përzgjedhja e klasave në të cilën do të ushtrohet veprimtaria e agentit, do të argumentohet nga plani i biznesit, rregullat e brendshme, si dhe Vendimi i miratimit të agjentëve të punësuar.*
- 2. Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.*

**DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË  
APLIKIMIT TE BANKËS/DEGËS SE BANKËS SË HUAJ DHE SUBJEKTEVE  
FINANCIARE JOBANKA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT  
NË SIGURIME**

1. Kërkesa e Bankës dhe/ose degës së bankës së huaj si dhe subjektit financiar jobankë, që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime, duhet të shoqërohet me:
  - a. Vendimin e miratimit nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime ;
  - b. Të dhëna për strukturën/njësinë që do kryejë veprimtarinë e agjentit;
  - c. Listën e agjentëve të punësuar dhe dokumentacion përkatës të tyre në përmbushje të kërkesave të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
  - d. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
    - i. Mënyrën e informimit dhe trajtimit të ankesave;
    - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
  - e. Kopje e marrëveshjes së bankes/degës së bankës së huaj apo subjektit financiar jobankë me shoqërinë e sigurimit, në emër dhe për llogari të së cilës do të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime.
  - f. Dokumentin që vërteton pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014.

**Shënim:** Banka/dega e bankës së huaj apo subjekti financiar jobankë që kërkon të ushtrojë veprimtari agjenti në sigurime, para fillimit te aktivitetit duhet të disponojë:

sigurimin e përgjegjësisë profesionale ndaj palëve të treta, kundrejt dëmeve të shkaktuara nga kryerja e veprimtarisë së agjentit në një shumë jo më të vogël se 100,000 lekë për cdo ngjarje të siguruar, ose jo më të vogël se 150,000 Lekë në vit për të gjitha rastet e sigurimit.

Subjekti financiar jobankë para fillimit te aktivitetit duhet të disponojë dokumentin bankar që vërteton depozitim në një llogari qëllimore të garancise financiare.